

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për informacionin e klasifikuar”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	DSIK- Kryeministria
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Transpozim i pjesshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Vendim i Këshillit të Bashkimit Evropian të 23 shtatorit 2013 “Për rregullat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar” 2013/488/BE, i ndryshuar.
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Vendimi i Këshillit të datës 23 shtator 2013 “Mbi rregullat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të BE”(2013/488/BE). NR.CELEX 32013D0488, “Fletore zyrtare” e Bashkimit Evropian seria L, nr.274, datë15.12.2013, faqe 1-50. https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uriserv%3AOJ.L_.2013.274.01.0001.01.ENG&toc=OJ%3AL%3A2013%3A274%3ATOC Dokumenti i Politikës së Sigurisë së NATO-s, NATO-C-M(2002)49, i ndryshuar. https://www.nbf.hu/docs/C-M(2002)49-REV1.pdf
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	20/12/2021 – 20/01/2022
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	12/07/2022
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Po 09/05/2022
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	01-2022
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Enton Sadiku Marsida Fetishi marsida.fetishi@nsa.gov.al Ada Çela ada.cela@nsa.gov.al
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT	
<i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë. (jo më shumë se 10 rreshta)</i>	

Mbrojtja e informacionit të klasifikuar nga humbja, dëmtimi, rrjedhja, kompromentimi ose ekspozimi i paautorizuar është një nga prioritetet e shtetit shqiptar. DSIK, me qëllim përmbushjen e këtij prioriteti ka rishikuar dhe përshtatur bazën ligjore për informacionin e klasifikuar, duke e harmonizuar me standardet e vendeve të BE-së dhe të NATO-s.

Plotësimi i kuadrit rregullator në këtë drejtim është detyrim i vendit edhe në kuadër të procesit të integritetit evropian. Plani Kombëtar i Integritetit Evropian të Republikës së Shqipërisë viti 2021- 2022 ka parashikuar përafrimin pjesërisht të Vendimit të Këshillit të datës 23 shtator 2013 “Mbi rregullat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të BE”(2013/488/BE).

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit? (jo më shumë se 7 rreshta)

Objektivat kryesorë që synohen nëpërmjet kësaj iniciative konsistojnë, si më poshtë vijon:

- Standartizimi i procedurave për sigurimin e informacionit të klasifikuar në institucionet e administratës publike.
- Rritja e standardeve të sigurisë.
- Transpozimi i legjislacionit të Bashkimit Evropian.
- Rritja e transparencës së klasifikimit duke kufizuar interpretimin e parregullt.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimëve kryesorë dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Për arritjen e objektivave të politikës janë shqyrtuar opsionet e mëposhtme:

- **Opsioni 0** (*status quo*): - Ruajtja e “status quo”-së (duke mosndërruar me amendime të mëtejshme, në ligjin ekzistues dhe duke mos hartuar një projektligji të ri);
- **Opsioni 1**: Amendimi (ndryshimi) i ligjit ekzistues (nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, i ndryshuar
- **Opsioni 2**: Hartimi dhe miratimi i një ligji të ri,

Opsioni 0 – Ruajtja e *status quo*-së dhe vijimi me kuadrin ligjor ekzistues, duke pritur që situata të vetërregullohet, pa ndërhyrjen e pushtetit legjislativ. Kjo situatë nuk ka kosto financiare, por nga ana tjetër, nuk jep zgjidhje të problemeve që janë hasur gjatë kryerjes së veprimtarisë. Të gjitha ato situata juridike që kërkojnë ndërhyrje nëpërmjet ndryshimeve ligjore, ngelen të parregulluara dhe të patrajtuara sipas nevojave të sotme praktike, siç janë sigurimi i sistemeve të komunikimit dhe informacionit, siguria kibernetike, shklejet e sigurisë, menaxhim i riskut dhe kërcënimet e sigurisë.

Opsioni 1: – Amendimi (ndryshimi) i ligjit aktual (nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, i ndryshuar përbën avantazh në krahasim me Opsionin 0, pasi nëpërmjet amendimit mund të rregullohen një pjesë e problematikave, nga ana tjetër meqenëse ndryshimet prekin mbi 50% të dispozitave të ligjit aktual.

Amendimi i mëtejshëm i tij do të vështirësonte përdorimin me efikasitet të vetë ligjit në fjalë, gjë e cila përbën përveç të tjerash një disavantazh, ndaj edhe këtë opsion e konsiderojmë të papërshtatshëm, krahasuar me Opsionin 2.

Opsioni 2 – Hartimi dhe miratimi i një ligji të ri, i cili do të rregullonte këtë fushë ushtrimi veprimtarie për informacionin e klasifikuar në mënyrë të plotë është opsioni i preferuar. Në projektligji u janë ngarkuar detyra institucioneve në fushën e sigurisë. Këto institucioneve dalin si autoritete kombëtare në fushën e informacionit të klasifikuar, si Autoritetet Verifikuese në procedurat e pajisjes me certifikate sigurie personeli, Autoritet Kombëtar në fushën e mbrojtjes kibernetike për sistemet e komunikimit dhe informacionit (SKI) ku trajtohet informacioni i klasifikuar, Autoritet Kombëtar për akreditimin e sigurisë për sistemet e komunikimit dhe informacionit (SKI), Autoriteti i Sigurisë Kombëtare në marrëdhënie me NATO-n, BE-në, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuara dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuara mbi buxhetin dhe bizneset.

Opsioni i rekomanduar/i preferuar është Opsioni 2, i cili do të sigurojë një bazë të re ligjore, që do të mundësojë realizimin edhe më gjithëpërfshirës të rolit të DSIK në fushën e informacionit të klasifikuar. Garantimin e një politike të qartë në mbrojtjen e informacionit të klasifikuar sipas standarteve të BE-së dhe NATO.

Kosto në buxhetin e shtetit: Përzgjedhja e opsionit të preferuar - opsioni 2, sjell ndikime me vlerë monetare pas miratimit të tij, pasi parashikohet shtesë mbi pagë për shkak të natyrës së veçantë të punës për personelin e DSIK, nisur nga fusha e veprimtarisë, misionit të veçantë dhe specifik të DSIK, si Autoritet i Sigurisë Kombëtare për informacionin e klasifikuar. Kostot janë përllogaritur dhe paraqitur në shtojcën 2/a (Raporti i vlerësimit të ndikimit)

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfutimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta)

Pas shqyrtimit të alternativave, opsioni i preferuar përzgjidhet opsioni 2, krijimi i një ligji të ri që ka për qëllim përcaktimin e parimeve dhe rregullave për krijimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e informacionit të klasifikuar gjatë të gjithë ciklit jetësor të tij. Një ligj i ri është opsioni i preferuar pasi ndryshimet e propozuara përfshijnë më shumë se 50% të ligjit aktual në fuqi nr. 8457/1999.

Kostoja e përllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-veçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
9,120	9,120	9,120

Në mijë lekë

Nr.	Përshkrimi	Nr. Punonjësve të DSIK	Viti 1	Viti 2	Viti 3
1	Shtesë mbi pagë për shkak të natyrës së veçantë të punës	38	9,120	9,120	9,120
	Shuma		9,120	9,120	9,120

Në projektligj nuk parashikohet krijimi i ndonjë strukture të re dhe as i ndonjë institucioni të ri, gjë që do të shoqërohej me efekte financiare për buxhetin e shtetit, por në bazë të nenit 68, të projektligjit, është parashikuar që për shkak të natyrës së veçantë të punës, punonjësi i DSIK-së trajtohet me shtesë mbi pagë. Masa e shtesës mbi pagë përcaktohet me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave si një akt nënligjor që nxirret në zbatim të legjislacionit përkatës në fuqi (ligjit për kompetencën e pagave dhe ligjit për nëpunësin civil, vendimi nr.187/2017, i Këshillit të Ministrave, i ndryshuar).

Me miratimin e projektligjit, efekti i shtesës së propozuar në buxhetin e shtetit është 9,120 mijë lekë për një vit kalendarik të plotë. Vlera e parashikuar për trajtimin me shtesë mbi pagë për natyrë të veçantë pune është parashikuar në Programin Buxhetor Afatmesëm 2023 -2026.

KONSULTIMI

Jepni një përmbljedhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

Projektakti është hartuar nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe bashkërenduar me ministrinë dhe institucionet shtetërore.

Projektligji i është dërguar për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Mbrojtjes, APP, DAP, SHISH dhe AKSHI-t, KLGJ-së, KLP-së, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Prokurorisë së Përgjithshme.

Në zbatim të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, Kryeministria ka publikuar në portalin e Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike draftin e projektligjit “Për informacionin e klasifikuar”, I cili ka qenë i hapur në 20/12/2021 – 20/01/2022. Nga portali nuk janë administruar komente apo sugjerime mbi draftin në fjalë.

Gjithashtu, është realizuar konsultimi përmes e-akteve nga data 20.12.2021 – 14.06.2022. Institucionet të cilat kanë dhënë mendime në rrugë zyrtare janë Ministria e Drejtësisë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Brendshme dhe DAP, të cilat parimisht janë shprehur dakord me përmbajtjen e këtij projektligji, duke dhënë komente dhe sugjerime të cilat janë reflektuar në projektligj dhe janë analizuar në relacionin shpjegues.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?(jo më shumë se 5 rreshta)

Pas hyrjes në fuqi të projektligjit, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, në cilësinë e autoritetit përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar, ngarkohet që të hartojë aktet nënligjore përkatëse në zbatim të këtij ligji dhe për kontrollin e zbatimit të kërkesave të projektligjit.

Aktet nënligjore do të zbatohet nga të gjitha institucionet e administratës publike apo personat fizikë dhe juridikë që prodhojnë apo administrojnë informacion të klasifikuar.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Jepni kontekstin e politikës.

Si rezultat i ndryshimit të mjedisit të sigurisë dhe konkretisht, kërcënimeve hibride, NATO ka rishikuar Dokumentin e Politikës së Sigurisë dhe Direktivat për sigurimin e informacionit të klasifikuar. Në këtë kuadër, të gjitha vendet anëtare të NATO-s kanë detyrimin ligjor që të përafrojnë legjislativën e tyre me këto ndryshime të hartuara prej saj.

Duke qënë se, nga periudha e miratimit të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, të ndryshuar, kanë ndodhur një sërë ndryshimesh të pozitës së vendit tonë në raport me organizatat ndërkombëtare, si anëtarësimi në NATO dhe marrja e statusit të vendit kandidat në Bashkimin Evropian, kërkohet një qasje tjetër për administrimin e informacionit të klasifikuar, në veçanti për mbrojtjen e tij sipas standardeve të vendeve anëtare të NATO-s dhe të BE-së.

Në këto kushte, përcaktimi i parimeve dhe rregullave mbi të cilat duhet të bazohen institucionet e administratës publike, personat fizikë dhe juridikë për krijimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, NATO, BE, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare gjatë të gjithë ciklit jetësor të tij është një nevojë e domosdoshme për t’iu përgjigjur sa më mirë standardeve ndërkombëtare.

Informacioni i klasifikuar rregullohet dhe nga një paketë aktesh nënligjore si:

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 263, datë 12.05.2021 “Për miratimin e rregullores për klasifikimin e informacionit “Sekret shtetëror”.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 542, datë 25.07.2019 “Për miratimin e rregullores “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar që trajtohet në sistemet e komunikimit dhe të informacionit (SKI).

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 690, datë 05.10.2011 “Për miratimin e rregullores “Për mbrojtjen kriptografike të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror””.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 23.06.2010 “Për miratimin e rregullores “Për transportimin fizik të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror””.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 312, datë 16.03.2011 “Për miratimin e rregullores “Për punën me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 189, datë 04.03.2015 “Për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, të NATO-s, BE-së, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare”.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 542, datë 29.09.2021 “Për rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 81, datë 28.01.2008 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për asgjësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”. (ndryshuar me vendimin nr. 190, datë 4.03.2015)

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 377, datë 31.05.2001 “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” në marrëdhëniet ndërkombëtare” (ndryshuar me vendimin nr. 122, datë 17.02.2010)

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 836, datë 14.10.2015 “Për miratimin e rregullores “Për punën me informacionin e klasifikuar të NATO-s dhe Bashkimit Evropian”.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.03.2015 për miratimin e rregullores “Për sigurimin e personelit”.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Ligji ekzistues 8457/1999 për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” ka lënë pa trajtuar disa disiplina për informacionin e klasifikuar, si siguria e sistemeve të komunikimit dhe informacionit; aspekte të mbrojtjes kibernetike për sistemet e komunikimit ku trajtohet informacioni i klasifikuar; projektet e klasifikuara dhe siguria industriale; nuk është parashikuar mbikëqyrja dhe inspektimi i sigurisë, nuk janë parashikuar llojet e shkeljeve të sigurisë dhe sanksionet përkatëse.

Në kuadër të ndryshimeve të pozitës së vendit tonë, në raport me organizatat ndërkombëtare, diktohet i nevojshëm përkufizimi i termave lidhur me procese të ndryshme pune me informacionin e klasifikuar, si dhe përcaktimi i autoriteteve përgjegjëse në këtë fushë, si: “Akreditim i Sigurisë”, “Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar”, “Deklarata e Akreditimit të Sigurisë (DAS)”, “Kriptologji” etj.

Në ligjin aktual nuk ka masa shtrënguese administrative për zbatimin e legjislacionit për informacionin e klasifikuar.

Kategoritë e informacioneve që i nënshtrohen procesit të klasifikimit nuk janë mjaftueshëmrisht të detajuara e për këtë arsye e vështirësojnë procesin e hartimit të listave të informacioneve të klasifikuara nga institucionet përgjegjëse, klasifikimi i parregullt i informacionit, mos plotësimi i kriterëve ligjore për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Gjithashtu, disa nga institucionet shtetërore nuk i kanë plotësuar rekomandimet që ka adresuar DSİK për sigurimin e informacionit të klasifikuar, si sisteme të komunikimit dhe informacionit të akredituara, certifikimi i personelit sipas listës së dokumenteve të klasifikuara dhe listës së funksioneve organike që kanë nevojë për njohje me informacion të klasifikuar.

Grupet e prekura janë: institucionet e administratës publike, sistemi i drejtësisë dhe prokurorisë, personat fizikë, juridikë, të cilët për ushtrimin e detyrave të tyre dhe bazuar në parimin “nevojë për njohje” kërkohet të kenë qasje në informacionin e klasifikuar.

Ndryshimet e propozuara në projektligjin “Për informacionin e klasifikuar”, do të adresojnë problematikat e listuara më lart dhe kjo do të ishte në funksion të rritjes së standarteve të sigurisë, si dhe integritetit të termave të përcaktuara në Dokumentin e Politikës së Sigurisë të NATO-s dhe politikën e BE-së për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Commented [DA1]: The questions have to be answered in a precise way.

Arsyet e ndërhyrjes së qeverisë dhe nevojshmëria.

Mbrojtja e informacionit të klasifikuar nga humbja, dëmtimi, rrjedhja, kompromentimi ose ekspozimi i paautorizuar është një nga prioritetet e shtetit shqiptar. DSİK me qëllim përmbushjen e këtij objekti ka rishikuar dhe ka përshtatur bazën ligjore për informacionin e klasifikuar.

Gjithashtu, arsyet e ndërhyrjes lidhen edhe me nevojën për të përditësuar kuadrin ligjor për informacionin e klasifikuar, si dhe për të harmonizuar e përshtatur sa më mirë me standardet e vendeve të BE-së dhe të NATO-s.

Plotësimi i kuadrit rregullator në këtë drejtim është detyrim i vendit edhe në kuadër të procesit të integritetit evropian. Plani Kombëtar i Integritetit Evropian të Republikës së Shqipërisë viti 2021- 2022 ka parashikuar përafrimin e pjesërisht të Vendimit të Këshillit të datës 23 shtator 2013 “Mbi rregullat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar të BE” (2013/488/BE).

Gjithashtu është dhe detyrimi i përshtatjes së legjislacionit të brendshëm me Dokumentin e Politikës së Sigurisë së NATO-s, NATO-C-M(2002)49, i ndryshuar si vend anëtar në NATO.

Projektligji është hartuar nga DSİK dhe është bashkëpunuar me Departamentin Juridik, në Kryeministri, për bashkërendimin e mendimeve me ministritë dhe institucionet shtetërore, si dhe është realizuar procesi i konsultimit publik.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*

- Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.

Objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.

- Standartizimi i procedurave për sigurimin e informacionit të klasifikuar në institucionet e administratës shtetërore.
- Ngritja e standarteve të sigurisë
- Transpozimi i acquis së BE-së.
- Rritja e transparencës së klasifikimit duke kufizuar interpretimin e parregullt.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- Përshkruani opsionin e status quo-së.
- Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që kenë marrë parasysht.
- Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.

Commented [DA2]: The questions have to be answered in a precise manner.

Opsioni 0 – status quo-ja **Opsioni 0** – Ruajtja e status quo-së dhe mosbërja e ndryshimeve ligjore. Kjo situatë nuk ka kosto financiare, por nga ana tjetër, nuk jep zgjidhje të problemeve që janë hasur gjatë kryerjes së veprimtarisë.

Opsioni

1: – përbën avantazh në krahasim me Opsioni 0, pasi nëpërmjet amendimit mund të rregullohen një pjesë e problematikave, nga ana tjetër meqenëse nëpërmjet ndryshimeve është ndryshuar mbi 50% e përmbajtjes fillestare të ligjit, ndryshimi (amendimi) i mëtejshëm i tij do të vështirësonte përdorimin me efikasitet të vetë ligjit në fjalë, gjë e cila përbën përveç të tjerash një disavantazh, ndaj edhe këtë opsion e konsiderojmë të papërshtatshëm, krahasuar me Opsionin 2.

Opsioni 2 – Hartimi dhe miratimi i një ligji, i cili do të rregullonte këtë fushë ushtrimi veprimtarie për informacionin e klasifikuar në mënyrë të plotë është opsioni i preferuar. Në projektligj u janë ngarkuar detyra institucioneve në fushën e sigurisë. Këto institucioneve dalin si autoritete kombëtare në fushën e informacionit të kalsifikuar, si Autoritetet Verifikuese në procedurat e pajisjes me certifikate sigurie personeli, Autoritet Kombëtar në fushën e mbrojtjes kibernetike për sistemet e komunikimit dhe informacionit (SKI) ku trajtohet informacioni i klasifikuar, Autoritet Kombëtar për akreditimin e sigurisë për sistemet e komunikimit dhe informacionit (SKI), Autoriteti i Sigurisë Kombëtare në marrëdhënie me NATO-n, BE-në, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- Identifikoni grupet e prekura.
- Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.
- Për ndikimet e drejtpërdrejta:
 - Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.
 - Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.
 - Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).
 - Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).
- Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:
 - Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.
 - Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.
- Diskutoni kufizimin e analizës:
 - Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.
 - Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasojat të papritura.

- **Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:**

- *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
- *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
- *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).*

Grupet e prekura në këtë projektligj janë: institucionet e administratës publike, sistemi i drejtësisë dhe prokurorisë, personat fizikë, juridikë, të cilët për ushtrimin e detyrave të tyre dhe bazuar në parimin “nevojë për njohje” kërkohet të kenë qasje në informacionin e klasifikuar

Ndikimet e drejtpërdrejta pozitive për qeverinë janë si më poshtë:

- Përbushja e detyrimeve në kuadër të përafritimit të legjislacionit me Acquis e BE-së dhe Dokumentin e Politikës së Sigurisë së NATO-s.
- Projektligji rrit standartet e sigurisë për informacionin e klasifikuar, çka do të thotë që ndikon pozitivisht sigurinë kombëtare dhe interesin publik.
- Kontributi i drejtpërdrejtë në sigurinë e informacionit të klasifikuar të NATO-s dhe BE-së, duke rritur kredibilitetin në arenën ndërkombëtare të Shqipërisë me partnerët apo organizatat ndërkombëtare.

Për operatorët ekonomik ka përfitime të drejtpërdrejta:

- U jepet mundësia ligjore që të konkurojnë në prokurimet e klasifikuara të organizuara nga NATO, BE apo vendet anëtare të tyre.

Ndikime jo të drejtpërdrejta

- Rritja e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstytucional.
- Rritja e përgjegjësisë për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për informacionin e klasifikuar.

Kosto në buxhetin e shtetit:

Në projektligj nuk parashikohet krijimi i ndonjë strukture të re dhe as i ndonjë institucioni të ri, gjë që do të shoqërohej me efekte financiare për buxhetin e shtetit, por në bazë të nenit 68, të projektligjit, është parashikuar që për shkak të natyrës së veçantë të punës, punonjësi i DSIK-së trajtohet me shtesë mbi pagë. Masa e shtesës mbi pagë përcaktohet me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave si një akt nënligjor që nxirret në zbatim të legjislacionit përkatës në fuqi (ligjit për kompetencën e pagave dhe ligjit për nëpunësin civil, vendimi nr.187/2017, i Këshillit të Ministrave, i ndryshuar). Me miratimin e projektligjit, efekti i shtesës së propozuar në buxhetin e shtetit është 9,120 mijë lekë për një vit kalendarik të plotë. Vlera e parashikuar për trajtimin me shtesë mbi pagë për natyrë të veçantë pune është parashikuar në Programin Buxhetor Afatmesëm 2023 -2026.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni i rekomanduar/i preferuar është: Opsioni i preferuar është përzgjedhur opsioni 2, hartimi dhe miratimin i një ligji të ri që ka për qëllim mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë të gjithë ciklit jetësor të tij. Inicimi i këtij projektligji lidhet me nevojën për të përditësuar kuadrin ligjor për informacionin e klasifikuar, si dhe për të harmonizuar e përshtatur sa më mirë kuadrin ligjor për disiplinat e informacionit të klasifikuar me standartet e vendeve të BE-së dhe të NATO-s.

Në projektligj u janë ngarkuar detyra institucioneve në fushën e sigurisë. Këto institucioneve dalin si autoritete kombëtare në fushën e informacionit të kalsifikuar, si Autoritetet Verifikuese në procedurat e pajisjes me certifikate sigurie personeli, Autoritet Kombëtar në fushën e mbrojtjes kibernetike për sistemet

e komunikimit dhe informacionit (SKI) ku trajtohet informacioni i klasifikuar, Autoritet Kombëtar për akreditimin e sigurisë për sistemet e komunikimit dhe informacionit (SKI), Autoriteti i Sigurisë Kombëtare në marrëdhënie me NATO-n, BE-në, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare..

Në frymën e këtyre detyrimeve ndërkombëtare, projektligji është realizuar duke u mbështetur në:

- Vendimin e Këshillit të Bashkimit Evropian të 23 shtatorit 2013 “Për rregullat e sigurisë për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar” 2013/488/BE, të ndryshuar, si dhe
- Dokumentin e Politikës së Sigurisë së NATO-s, NATO-C-M(2002)49, miratuar në vitin 2019.

Miratimi i një ligji të ri përbën avantazh dhe sjell si rrisi:

Rregullimi i disiplinave për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar si: “Siguria e sistemeve të komunikimit dhe informacionit” dhe “Siguria industriale”, të cilat nuk kanë qenë të rregulluara në ligjin aktual.

Përcaktimi në ligj i autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar në sistemet e komunikimit dhe informacionit. Autoritetet përgjegjëse janë Autoriteti i Certifikim Vlerësimit, Akreditimit, Shpërndarjes, Tempest dhe Mbrojtjes Kibernetike. Janë identifikuar strukturat shtetërore, të cilat ngarkohen me ushtrimin e këtyre autoriteteve.

Trajtimi i parimit “*after care*”. Sipas këtij parimi, masat e sigurisë dhe verifikimi i sigurisë për personat që kanë qasje tek informacioni i klasifikuar vazhdon edhe pas certifikimit të përshtatshëm të tyre dhe autorizimit për njohje me informacionin e klasifikuar.

Detajimi i kategorive të informacionit që do t'i nënshtrohen procesit të klasifikimit duke e bërë më të lehtë orientimin e institucioneve për të hartuar listat e informacioneve të klasifikuara. Kjo masë do të shmangë mbiklasifikimin dhe do të rrisë më shumë sigurinë e informacionit të klasifikuar duke alokuar burime njerëzore e materiale vetëm për informacionin e klasifikuar. Kjo masë, gjithashtu, synon të rrisë më shumë transparencën e klasifikimit duke kufizuar interpretimin e autoritetit klasifikues e si rrjedhojë klasifikimin e parregullt. DSIK merr një rol rregullator duke patur kompetencë për të ndërhyrë në rast klasifikimi të parregullt.

Përjashtimi i procedurave të verifikimit të sigurisë për Presidentin e Republikës së Shqipërisë dhe Kryeministrin, të cilët autorizohen të kenë qasje tek informacioni i klasifikuar, për shkak të kryerjes së detyrave të tyre zyrtare pajisen me CSP pa u kryer verifikimi i sigurisë.

Në projektligj është trajtuar edhe Informacioni i Klasifikuar i BE-së, i cili regjistrohet, shpërndahet, administrohet sipas standardeve që sigurojnë shkallë mbrojtjeje të njëjtë me atë që kërkohet nga BE në zbatim të marrëveshjeve të përgjithshme të sigurisë.

Në projektligj është parashikuar deklasifikimi i pjesshëm, duke rregulluar për herë të parë mundësinë për të zbuluar në mënyrë të autorizuar informacione, të cilat mund të ndahen nga informacioni që nuk mund të deklasifikohet. Në këtë mënyrë rritet më shumë transparenca dhe llogaridhënia e institucioneve shtetërore. Rritja e kuadrin të transparencës lidhur me publikimin e çështjeve të ndërlidhura me detyrimet e palëve në kontratë, pa e cenuar sigurinë e informacionit të klasifikuar. Kështu institucioni shtetëror nuk mund ta refuzojë të drejtën e informimit automatikisht, por duhet ta shqyrtojë kërkesën në komisionin e deklasifikimit.

Për herë të parë është përkufizuar koncepti i pronësisë së huaj, si formë kontrolli apo influencë kërcënuese për sigurinë e informacionit të klasifikuar për llogari dhe në interes të vendeve apo palëve jo mike.

Për herë të parë janë përcaktuar shkeljet e sigurisë, duke i ndarë ato në të rënda e të lehta.

Gjithashtu, janë vendosur masa administrative ndaj personave përgjegjës të cilët kryejnë këto shkelje.

Opsionet që janë marrë në konsideratë për analizën me shumë kritere janë:

Opsioni 0: – Ruajtja e status quo-së, të vijohet me kuadrin ligjor ekzistues ;

Opsioni 1: – Amendimi (ndryshimi) i ligjit aktual (nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, i ndryshuar;

Opsioni 2:- Shfuqizimi i ligjit aktual dhe hartimi i një ligji të ri .

Për të vlerësuar opsionet duke përdorur analizën me shumë kriteret, janë ndjekur hapat e mëposhtëm:

Janë përcaktuar kriteret që tregojnë arritjen e objektivave:

1. Garantimi i standardeve të sigurisë;
2. Rritja e transparencës së klasifikimit nëpërmjet kufizimit të interpretimit të parregullt
3. Efikasiteti në transpozimin e acquis së BE-së.
4. Efektshmëria standardizimin e informacionit të klasifikuar
5. Efikasiteti në respektimin e rregullave të teknikës legjislative dhe garantimi i qartësisë juridike
6. Kosto - efektiviteti

Është vendosur pesha e kriterëve sipas rëndësisë relative:

1. Garantimi i standardeve të sigurisë - 5
2. Rritja e transparencës së klasifikimit nëpërmjet kufizimit të interpretimit të parregullt -5
3. Efikasiteti në transpozimin e acquis së BE-së - 4
4. Efektshmëria standardizimin e informacionit të klasifikuar - 4
5. Efikasiteti në respektimin e rregullave të teknikës legjislative dhe garantimi i qartësisë juridike -3
6. Kosto – efektiviteti - 4

Pra, për të bërë dallimin e opsioneve nga njëra-tjetra dhe me qëllim përzgjedhjen e opsionit më të mirë secili kriter është vlerësuar me një peshë specifike vlerësuar nga 1-5;

Gjithashtu, secili kriter në varësi të peshës së tij, është vlerësuar me pikë përkatëse sipas shkallës së preferencës për çdo opsion për secilin kriter nga 0-5 ku 0 përfaqëson opsionin më pak të preferuar dhe 5 atë më të preferuarin.

<i>Kriteret</i>	<i>Pesha</i>	<i>Opsioni 0</i>	<i>Opsioni 1</i>	<i>Opsioni 2</i>
Garantimi i standardeve të sigurisë	5	1 (5)	5 (25)	5 (25)
Rritja e transparencës së klasifikimit nëpërmjet kufizimit të interpretimit të parregullt	5	0 (0)	5 (25)	5 (25)
Efikasiteti në transpozimin e acquis së BE-së.	4	0 (0)	4 (16)	4 (16)
Efektshmëria standardizimin e informacionit të klasifikuar	4	1 (4)	3 (12)	3 (12)
Efikasiteti në respektimin e rregullave të teknikës legjislative dhe garantimi i qartësisë juridike	3	5 (15)	0 (0)	3 (9)
Kosto-efektiviteti	4	2 (8)	3 (12)	3 (12)
Total (pikët)		27	90	99

Çështje të zbatimit

- Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.
- Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.

- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*

Pas hyrjes në fuqi të ligjit, ngarkohet DSIK për hartimin e akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji, brenda 1 viti nga data e hyrjes në fuqi të tij. Aktet nënligjore që do të hartohen janë Vendime të Këshillit të Ministrave, që do të përcaktojnë:

1. Krijimin, klasifikimin, regjistrimin, qarkullimin, shfrytëzimin, shumëfishimin, arkivimin, sigurimin fizik, transportimin fizik, deklasifikimin, zhvlerësimin, asgjësimin dhe shkatërrimin e informacionit të klasifikuar.
2. Procedurat dhe përgjegjësitë e institucioneve për verifikimin e sigurisë dhe lëshimin, refuzimin, pezullimin e përkohshëm ose revokimin e “Certifikatës së Sigurisë së Personelit”.
3. Rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë; etj.

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohen institucionet e administratës publike dhe operatorët ekonomikë të interesuar, kontraktorët/nënkontraktorët, të cilët duhet të marrin masa për zbatimin e kërkesave të ligjit dhe që prodhojnë apo administrojnë informacion të klasifikuar. Masat janë të tilla si krijimin, administritimin, qarkullimin, shfrytëzimin, deklasifikimin, zhvlerësimin, asgjësimin dhe transportimin, transmetimin e informacionit të klasifikuar.

Gjithashtu, ngarkohet DSIK në cilësinë e autoritetit përgjegjës për sigurinë e informacionit të klasifikuar, për kontrollin e zbatimit të kërkesave të këtij ligji.

Nëpërmjet këtij projektligji, DSIK tani jep jo vetëm rekomandime, por në rastet kur konstaton incidentet apo shkeljet e sigurisë edhe masa administrative. Në këtë kuadër synohet edukimi i sigurisë për personelin që punon dhe ka akses në informacionin e klasifikuar.

Faza e monitorimit dhe vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmblëdhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.*

Monitorimi i zbatimit të këtij projektligji do të bëhet nga Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, përmes inspektimeve.

Kriter matje do të shërbejnë raportet e inspektimit, numri i inspektimeve, numri i shkeljeve të kryera nga subjektet e ngarkuara nga ligji, numri i masave disiplinore të dhëna dhe numri i rekomandimeve të zbatuara nga institucionet shtetërore.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin - një herë										
Kosto për buxhetin - në vazhdimësi										
Kosto për bizneset - një herë										
Kosto për bizneset - në vazhdimësi										

Kosto për grupet e tjera - një herë										
Kosto për grupet e tjera - në vazhdimësi										
Kosto në total	9.1 (vjetore)	9.1 (vjetore)	9.1 (vjetore)							
Kosto e zbritur= Kosto në total x Faktori zbritës										
Përfitimet për buxhetin – një herë										
Përfitimet për buxhetin – në vazhdimësi										
Përfitimet për grupet e tjera – një herë										
Përfitimet për grupet e tjera – në vazhdimësi										
Përfitimet për biznesin – një herë										
Përfitimet për biznesin – në vazhdimësi										
Përfitimet totale										
Përfitimi i zbritur= Përfitimi në total x faktori zbritës										
Vlera prezente aktuale e përfitimit në total										
Vlera prezente aktuale e kostos në total										
Vlera Prezente Neto Aktuale (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	0	0	0
Opsioni 2	0	0	0